



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 06.10.2016

**Vendim**  
**Nr. 40, datë 06.10.2016**

**PËR PËRCAKTIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN**  
**E STATUTIT TË RI DHE RREGULLORES SË RE**  
**TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit **38** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në funksion të hartimit të Statutit të ri dhe Rregullores së re të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.10.2016

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin që Departamenti i Drejtësisë të fillojë punën për hartimin e Statutit të ri dhe Rregullores së re të UV-së, si dy dokumente të rëndësishme të jetës së UV-së.
2. Përgjegjës i grupit të punës për hartimin e këtyre dokumenteve të jetë drejtuesi i njësisë bazë, kurse relator përfaqësuesi i departamentit në senat.
3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.